



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.02.2021, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtim në parim i projektligjit “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Artemis Dralo, Elena Xhina, Antoneta Dhima, Myslim Murrizi, Ylli Shehu, Xhemal Qefalia, Lefter Maliqi, Edmond Stojku, Edmond Rrushi, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Arben Elezi, Elona Hoxha Spartak Braho.

Mungojnë:

Alban Zeneli, Paulin Sterkaj, Anduel Xhindi, Luan Harusha, Nimet Musai

Të ftuar:

Julian Hodaj – Zëvendësministër i Brendshëm

Elena Pici – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Brendshme

Fatmir Shehu – Drejtor Juridik në Ministrinë e Brendshme

Krenar Dervishi – Përgjegjës i Burimeve Njerëzore, Garda e Republikës.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi, kolegë!

Meqenëse kuorumi i Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare është i plotë, e deklaroj të hapur mbledhjen e planifikuar për sot.

Në rendin e ditës kemi shqyrtimin në parim të projektligjit “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.

Propozimi vjen nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet Ministrisë së Brendshme. Natyrisht, është një propozim i ri për një ligj të ri të Gardës së Republikës, ndërkohë që është edhe një premtim i kahershëm që Gardës së Republikës t’i jepnim një ligj të vetin.

Të ftuar për të prezantuar projektin kemi: zotin Juljan Hodaj, zëvendësministër i Brendshëm, zonjën Elena Pici, sekretaren e Përgjithshme, zotin Fatmir Shehu, drejtor Juridik në Ministrinë e Brendshme, dhe zotin Krenar Dervishi, përgjegjës i Burimeve Njerëzore në Gardën e Republikës.

U uroj të gjithë përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme mirë se ardhjen në komision tonë!

Ndërkohë, nga ana e Komisionit të Sigurisë Kombëtare, relatore do të jetë zonja Artemis Dralo.

Para se t’ia jap fjalën zotit Hodaj për të bërë prezantimin e projektligjit, më lejoni të uroj një nga kolegët tanë, zotin Ylli Shehu për ditëlindjen, meqenëse është një përvjetor i rëndësishëm. Edhe 100, Ylli! Kalofsh sa më bukur!

(Diskutim pa mikrofon)

Zoti Zëvendësministër, fjala është për ju, për të na bërë prezantimin e projektit. Sot kemi vendosur t’ju dëgjojmë ju, dhe përfaqësuesin e Gardës së Republikës, për komentet që kanë për projektligjin dhe do të ecim vetëm me miratimin në parim të projektit, më pas, në një mbledhje tjetër, do të kalojmë në diskutimin nen për nen dhe miratimin në tërësi.

Juljan Hodaj – E nderuar kryetare,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Bashkohem edhe unë me ju për t’i uruar ditëlindjen zotit Shehu. Edhe 100 ditë të tjera si kjo e sotnja!

Bashkohem si rrallëherë me zotin Murrizi për llojin e një ditëlindjeje. Besoj se me mbarimin e këtij viti të vështirë, me nisjen e vaksinimit dhe funksionimin e masave që ka marrë qeveria, do të kemi mundësi që në një të ardhme të afërt të mos kufizohemi vetëm me urimet *online*.

Ju faleminderit për këtë mundësi!

Ju e përmendët, duke ditur që ky është një angazhim i kahershëm për të modernizuar Gardën e Republikës. Projektligji që propozohet sot, zëvendëson një projektligj, që mund të jetë nga më jetëgjatët në Republikën e Shqipërisë, sepse është miratuar në vitin 2003 dhe është amenduar për herë të vetme në vitin 2005. Në atë kohë gjërat ishin shumë ndryshe dhe arkitektura institucionale e Republikës së Shqipërisë ishte shumë ndryshe. Kujtojmë që në atë kohë ruajtja e personaliteteve apo e objekteve të rëndësisë së veçantë kryhej edhe me ushtarë të shërbimit të detyruar dhe për këtë arsye Garda e Republikës ka këtë lloj arkitekture të bazuar mbi grada ushtarake dhe me një hierarki apo organizim të brendshëm tipikisht të Forcave të Armatosura.

Angazhimi i kësaj qeverie që në vitin 2013 ka qenë që Garda të civilizohet (nëse më lejohet termi), pra të kthehet në një organizatë civile, që u shërben qëllimeve të saj dhe të inkuadrohet në mënyrë harmonike me atë që është edhe organizimi i institucioneve në varësi të Ministrisë së Brendshme, të cilat janë përgjegjëse në fund të ditës për rendin dhe sigurinë publike në Republikën e Shqipërisë.

Eksperiencia e gjatë e ligjit në fuqi ka mësuar disa gjëra dhe ka vënë në pah disa nevoja imediate për t'u adresuar në raport me organizimin ligjor dhe strukturor të Gardës, ndaj ky projektligj i ri propozohet sot për të mbuluar qoftë edhe ato boshllëqe, por edhe për të dhënë edhe një vizion të ri të asaj që do të jetë Garda Republike e së ardhmes, pa i cenuar funksionalitetin që ka edhe në ditët e sotme dhe vendin që zë në strukturat apo institucionet që i shërbejnë sigurisë publike në vend.

Nga eksperiencia e këtyre shumë viteve, po flasim për më tepër se 17 vjet, kanë dalë në pah disa nevoja që duheshin adresuar.

E para lidhet me parimet që duhet të udhëheqin Gardën e Republikës, pra që çojnë edhe në transformimin e saj me atë që duhet të jetë të nesërmen. Një projektligj i ri këtë bën, adreson disa parime, të cilat fillojnë që nga respektimi i të drejtave themelore të njeriut deri te mënyra se si duhet të zbatohen këto parime në praktikë.

Një çështje e dytë që ngeli problematike dhe duhet adresuar patjetër, është roli i ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, si organi kryesor politik dhe që ka drejtimin strategjik të Gardës, kuptohet, në raport dhe në harmoni të plotë të asaj që është edhe roli i ministrit në krahasim me strukturat e tjera të varësisë që kryejnë po funksione në fushën e sigurisë publike.

Një risi e tretë që projektligji sjell është një përcaktim më i qartë i kriterëve për emërimin, lirimin nga detyra të drejtorit të Përgjithshëm, si dhe përgjegjësisë specifike, duke

shkuar pastaj edhe te detyrat specifike që duhet të kryejë Garda e Republikës, ku në ligjin ekzistues janë shumë të përgjithshme dhe mund të çonin në probleme në interpretimin e tyre ditë pas dite, por duke i përcaktuar më qartë, i jepet edhe forma e asaj që do të jetë institucioni i së ardhmes.

Një risi tjetër është njehsimi apo përshtatja e organizimit të brendshëm qoftë në terma rekrutimi, trajnimit, edukimi, ecuri në karrierë apo gradash me ato që janë edhe institucionet e tjera në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Kemi një eksperiencë shumë të mirë me Policinë e Shtetit, duke filluar që nga viti 2014 me ligjin e ri, është implementuar e njëjta logjikë me SHÇBA-në, duke iu dhënë grada civile. E njëjta gjë që bën projektligji sot, që ju keni për shqyrtim, është edhe sistemi e gradave të Gardës së Republikës së Shqipërisë, që deri më sot janë sipas konceptit ushtarak, t'i kthejmë në grada civile dhe do të kemi më së fundi, tri institucione kryesore në varësi të Ministrisë së Brendshme që kanë të njëjtin sistem jo vetëm gradash, por edhe rekrutimi dhe promovimi në karrierë. Kjo është një risi jo pak e rëndësishme, duke pasur parasysh që eliminon atë që mund të ishte paqartësi e krijuar ndër vite në lidhje me statusin që një organizatë mund të ketë në raport me tjetrën kur kryen detyra që i përkasin të njëjtës fushë përgjegjësie.

Projektligji vjen si një projektligj i ri edhe për shkak të detyrimeve që kemi ndaj parimeve të teknikës legjislative, duke qenë se, meqë ndërrohet më tepër se gjysma e neneve, duhet të vinim me një projektligj të ri dhe jo thjesht me amendime të ligjit ekzistues.

Lidhur me projektligjin që keni para dhe ne që po e diskutojmë në parim, nuk do të doja të zgjatesha në detaje për nene të veçanta, sepse besoj se në seancat e tjera të komisionit do të kemi mundësi t'i diskutojmë nen për nen, qoftë edhe në mendimet që do të kenë deputetët e komisionit, besoj kjo na çon në një risi dhe premtim të mbajtur sa i përket pjesës së organizimit dhe funksionimit të gradave.

Sa i përket pjesës buxhetore nuk kemi probleme në këtë pjesë, pasi numri i punonjësve të Gardës së Republikës mbetet i njëjtë dhe sërish Garda, edhe në organizim e ri, do të funksionojë me të njëjtat numra, edhe në qoftë se shihni nuk ka efekt financiar, pasi, nëse shihni relacionin, ku përshkruhet pjesa e buxhetit, do të shihni nëse ka një ulje në raport me gradat e mëdha, ka një trajtim më të mirë financiar të gradave të ulëta, që ne mendojmë se është i rëndësishëm dhe duhet të raportojmë edhe me punonjësit e institucioneve të tjera që janë në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Me lejen tuaj, do të doja të ndalesha këtu, por jam i gatshëm të jap detaje dhe shpjegime të tjera nëse ju e gjykoni të nevojshme.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Hodaj, për prezantimin tuaj!

Është e qartë që projekti synon të reformojë Gardën e Republikës, duke i dhënë asaj një qasje sa më bashkëkohore në kushtet dhe rrethanat e sotme.

Jam dakord me ju që përvoja e akumuluar prej vitit 2003 deri më sot është, natyrisht, një përvojë e mjaftueshme për të ndërtuar një projekt të duhur.

Gjithsesi, do të më duhet t’ia kaloj fjalën përfaqësuesi të Gardës së Republikës, zotit Krenar Dervishi, si përgjegjës i burimeve njerëzore, si një pjesëtar i Gardës, sepse, besoj se do të ishte me interes edhe për të gjithë anëtarët e komisionit tonë të kishim një qëndrim të shprehur në emër të Gardës së Republikës për këtë projekt.

Fjala për ju.

Krenar Dervishi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar zotërinj deputetë,

Ju faleminderit për angazhimin tuaj për ta bërë më në fund Gardën me një ligj të ri!

Nuk do të hyj në hollësi, të cilat zoti Zëvendësministër i shtjelloi, por do të thosha se ka ardhur koha, ndoshta jemi vonë në këtë drejtim, për ta bërë Gardën me një ligj të ri për të gjitha ato arsye që zëvendësministri listoi dhe për ato risi që sjell projektligji i ri.

Në praktikën e përditshme hasim shumë vështirësi me ligjin aktual, edhe për shkak të periudhës së gjatë në të cilën ky ligj është miratuar, edhe për shkak të ndryshimeve dhe dinamikës që ka sjellë jeta e përditshme, detyrat, misioni i Gardës. Mjafton t’ju kujtoj këtu që nga koha e miratimit të ligjit janë shtuar struktura të tjera, të cilat Garda i merr në ruajtje, siç janë organet e vetingut apo organet e reja të drejtësisë dhe marrëdhënia me këtë institucione është, në njëfarë mënyre, e pasanksionuar.

Ajo që ne e gjejmë shumë të rëndësishme për ne është që të gjitha aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji, do t’i japin një frymëmarrje tjetër Gardës. Kemi probleme dhe ndeshim vështirësi në marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore apo marrëdhëniet edhe me subjektet private gjatë ushtrimit të detyrës gjatë misionit, sepse shumë prej këtyre nuk janë të parashikuara në ligjin aktual.

Një tjetër risi, të cilën do të doja ta përmendja, pastaj është e drejta e ligjvënësit, mënyra se si do të vazhdojë dhe si do të procedohet më tej, është që ne kemi parashikuar në vitin aktual që disa funksioneve, një strukture të përcaktuar në Gardën e Republikës, t’u jepen atributet e Policisë Gjyqësore. Kjo jo vetëm për rritjen e sigurisë dhe për parandalimin e ngjarjeve, por e marrë thjesht, ne aktualisht nuk kemi akses në sisteme, që kontrollohen nga Policia e Shtetit, dhe mendojmë që është e domosdoshme për Gardën e Republikës, sepse lidhet pikërisht me

këtë, duhet të kesh atributet e Policisë Gjyqësore që të kesh më pas atributet për të hyrë në këto sisteme.

(Nuk dëgjohet)

Ermonela Felaj – Me sa duket keni një problem me lidhjen.

Krenar Dervishi – Besoj se tani dëgjohem.

Nuk kam ndonjë gjë tjetër për të shtuar, përveç atyre që tha zëvendësministri.

Ju falënderoj edhe një herë për angazhimin tuaj për ta bërë Gardën me një ligj të ri!

Jemi të gatshëm për çdo pyetje dhe sqarim që mund të na kërkon.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Dervishi!

Fjalën do t'ia kaloj relatores, zonjës Artemis Dralo, për të na bërë relatin në emër të Komisionit të Sigurisë dhe për të na shprehur pikëpamjet në raport me projektin e propozuar.

Artemis Dralo – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar përfaqësues,

Pikë së pari, më lejoni të theksoj se nevoja e kësaj nisme është diktuar edhe si prioritet i Ministrisë së Brendshme, konkretisht si përmbushje e prioritetit për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, forcimin e rendit dhe të sigurisë publike.

Kështu lindi domosdoshmëria e reformimit këtij kuadri ligjor për Gardën e Republikës, duke përcaktuar në mënyrën më të qartë dhe më të plotë detyrat dhe përgjegjësitë e këtij institucioni.

Qëllimi i këtij projektligji, kryesisht, është reformimi i Gardës, ashtu siç u përmend edhe nga parafolësit, si një ligj tashmë i vjetër, le ta konsiderojmë kështu, dhe në këtë mënyrë mundësohet përmirësimi i veprimtarisë së këtij institucioni në tërësi, por edhe përafrimi i tij me institucionet homologe.

Si objektivi i reformës së këtij ligji është parashikuar riorganizimi në tërësi i Gardës, duke përafruar statusin e punonjësit të këtij shërbimi me atë të punonjësit të Policisë së Shtetit, por njëkohësisht duke e ruajtur këtë mision.

Disa nga objektivat që duhet të theksohen, të cilat që synohen të arrihen me miratimin e këtij projektligji janë konkretisht:

- Përcaktimi me ligj të veçantë dhe të integruar të organizimit dhe të funksionimit të Gardës dhe të sistemit të gradave të karrierës së punonjësve të këtij institucioni;
- përcaktimi më i plotë i veprimtarisë së Gardës në tërësi;
- përcaktimi i qartë i autoriteteve dhe kompetencave të tyre;

- përcaktimi me ligj i kriterëve të emërimit, por edhe të lirimit të drejtorit të Përgjithshëm;

- përcaktimi me ligj i kriterëve të përgjithshme dhe i kriterëve të veçanta të pranimit të punonjësve, i autoriteteve përkatëse për nxjerrjen e akteve nënligjore në veçanti, duke ndarë përcaktimin e rregullave të brendshme të organizimit të Gardës nga drejtuesi.

Por këtu përfshihen edhe dispozita për personelin, disiplinën, pajisjet, mjetet, armatimin, sigurisht me vendim të Këshillit të Ministrave.

Qasja e përafërt me Policinë e Shtetit për sa i përket sistemit të gradave, arsimimit, marrëdhënieve të punës është sigurisht edhe një objektiv tjetër.

Hartimi i këtij projektligji vjen si domosdoshmëri e aktualitetit. Periudha mbi 15-vjeçare që ka kaluar nga ky ligj, i cili aktualisht vazhdon të jetë në fuqi, ka sjellë problematika dhe ka diktuar dinamika të punës, të cilat e kanë bërë të nevojshëm hartimin e këtij projektligji për një përshtatje sa më aktuale.

Në fakt, ligji nr. 8869, i datës 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, është miratuar në një kohë kur siguria e personaliteteve realizohej edhe nga ushtarë të shërbimit të detyrueshëm dhe rrjedhimisht struktura, përbërja organike, si dhe gradat mbartin terma që u përkasin strukturave të Forcave të Armatosura.

Ndër të tjera, nevoja e miratimit të një ligji organik të ri për Gardën e Republikës së Shqipërisë rrjedh, pasi ky institucion ofron sigurinë më të lartë dhe më të specializuar për personalitetet e larta shtetërore të vendit, gjithashtu siguron edhe personalitete të tjera shtetërore që për shkak të misionit, por edhe të funksioneve që ato kanë klasifikohen si të tillë. Organizimi, funksionimi, formimi profesional, kriteret e pranimit, detyrat dhe përgjegjësitë e Gardës janë specifika të ndryshme nga ato të strukturave të tjera të sigurisë në ministrinë përgjegjëse.

Strukturat e tjera të fushës së sigurisë si Policia e Shtetit, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimi Informativ Shtetëror, Agjencia e Inteligjencës së Sigurisë dhe Mbrojtjes, Policia e Burgjeve, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, por edhe të tjera funksionojnë me ligje dhe organika të veçanta. Ky projektligj është parashikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave të 4-mujorit të dytë për vitin 2020 për Ministrinë e Brendshme.

Kuadri ligjor në fuqi, që rregullon veprimtarinë e Gardës ka hasur disa problematika, të cilat, në fakt, u përmendën, por, në fakt do të doja të ndaloja te disa problematika si përgjegjësia e institucionit, të cilat janë të përcaktuara në ligjin ekzistues. Ato janë shumë të përgjithshme, duke lënë kështu hapësira për keqinterpretim, por edhe për moszbatim.

Nuk parashikohen përgjegjësi dhe kompetenca për ministrin përgjegjës për Rendin dhe Sigurinë Publike si autoriteti më i lartë në nivel politik dhe strategjik të këtij institucioni. Përgjegjësitë dhe kompetencat e drejtuesit të Gardës rezultojnë jo të plota. Nuk parashikohen në ligjin ekzistues parimet mbi të cilat funksionon Garda, detyrat kryesore, veprimtaria, masat e sigurisë, por edhe simbolet, si dhe nuk janë përcaktuar në mënyrë të detajuar rregullat për marrëdhëniet të punës.

Në vijim të asaj që përmendi zëvendësministri ky projektligj sjell disa risi, si: parashikimi i të gjitha normave që e rregullojnë këtë veprimtari, duke u shmangur këto keqinterpretime; menaxhimi i strukturave bëhet më funksional dhe rritet efienca në punë; reformimi rrënjësor i të gjithë kuadrit ligjor; përmirësimin dhe garantimin e sigurisë për personalitetet në ruajtje.

Për shkak të rëndësisë së institucioneve koha e mbrojtjes së Presidentit, të Kryetarit të Kuvendit dhe të Kryeministrit pas përfundimit të mandatit apo të lirimt nga detyra ka ndryshuar në raport me përcaktimet në ligjin aktual.

Përcaktimi me ligj i kohës së ruajtjes dhe i mbrojtjes së banesës pas mbarimit të mandateve të personaliteteve përkatëse; parashikimi me ligj i sigurisë së presidentit të zgjedhur pas betimit të tij në Kuvend; përmirësimi i të drejtave të punonjësve të Gardës, sigurisht nuk duhet anashkaluar dhe duhet ndalur më me shumë vëmendje në çdo detaj dhe në çdo sugjerim apo kërkesë nga ana e institucionit të Gardës së Republikës.

Veprimtaria profesionale është e ndarë nga drejtimi politik dhe kjo është një risi; detyrat dhe përgjegjësitë e Gardës të përcaktohen me ligj dhe janë të njohura për publikun; rregullimi me ligj i çështjeve të formimit bazë, kualifikimeve, specializimeve, por sigurisht edhe të trajnimeve të vazhdueshme; ndryshimi i sistemit të gradave, duke filluar nga emërtimi, kriteret, procedurat e konkurrimit, por edhe të fitimit të gradës; përcaktimi i qartë i marrëdhënies institucionale ndërmjet ministrit përgjegjës për Rendin dhe Sigurinë Publike, por edhe drejtuesit të Gardës.

Ky projektligj është në përputhje të plotë me Kushtetutën, si dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi dhe garanton zbatimin e tyre, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Miratimi i këtij projektligji do të sjellë shfuqizimin e ligjit nr. 8869, të datës 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”” dhe të ligjit nr. 9366, datë 31.3.2005 “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”.

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis*-i të Bashkimit Europian. Është i ndarë në 13 krerë dhe në 72 nene, për të cilat do të ndalemi në mënyrë analitike. Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me trajtimet që parashikohen në nenin 13 të projektligjit, theksoj se nuk ka asnjë efekt financiar shtesë, pasi të gjitha këto detyra do të realizohen me stafin aktual të Gardës së Republikës së Shqipërisë, pra pa punonjës shtesë.

I ftoj të gjithë kolegët ta votojnë në parim këtë projektligj, por sigurisht do të ndalemi edhe në mënyrë analitike për të gjitha detajet që janë parashtruar!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, kolege!

Në fakt, projektligji duket goxha premtues në kuptimin e jetëgjatësisë, këtë mund ta konstatosh thjesht duke u nisur nga fakti që ligji aktual i Gardës, i cili daton në një kohë goxha të largët përmban vetëm 31 nene, ndërkohë që projektligji ri që propozohet përmban 72 nene dhe ka një rregullim të hollësishëm sa i takon organizimin, funksionimit, kritereve të pranimit dhe të qëndrimit në Gardën e Republikës, detyrave funksionale të Gardës së Republikës, duke filluar nga drejtuesit dhe deri në nivelin më të ulët.

Pra, qartësisht kishte ardhur koha që ne të kishim një propozim të tillë. Në vitin 2003, kur është bërë ligji, i cili rregullon funksionimin aktual të Gardës, ruajtja e personaliteteve të larta të shtetërore, por edhe e objekteve të rëndësisë së veçantë, bëhej nga ushtarë të shërbimit të detyrueshëm. Me sa duket kjo ishte një reminishencë e kohës së shkuar, ndaj së cilës ne nuk mund të qëndrojmë indiferentë dhe ka ardhur pikërisht momenti që të jemi të hapur në këtë diskutim dhe vërtet të mund ta reformojmë këtë strukturë të rëndësishme, e cila ka realisht një natyrë të veçantë në raport me institucionet e tjera që kanë si detyrë ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

Pas këtyre prezantimeve kuptohet që fjalën e ka kolegët për pyetje dhe diskutime.

Zoti Murrizi e ka kërkuar fjalën.

Myslim Murrizi - Faleminderit, zonja kryetare!

Kolegë, ju përshëndes!

Doja të bëja 2-3 pyetje.

Së pari, kemi një projektligj të ardhur nga Ministria e Brendshme apo ka edhe Garda e Republikës projektligj të saj in të propozuar për t'u miratuar?

Së dyti, desha të dija se cili model i vendeve të BE-së është marrë për analogji në hartimin e draftligjit nga Ministria e Brendshme. Cili nga vendet që na rrethon e zhvesh Gardën nga gradat ushtarake dhe e barazon me gradat e policisë?

Së treti, kam një tabelë pagash përpara në relacionin shpjegues dhe shoh që ka ulje pagash nga niveli aktual i pagave, duke i bërë gradën ushtarake dhe gradat civile që të përshtaten, sipas gradave që ka Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit?

Do të doja që të kishte qenë i pranishëm edhe komandanti i Gardës, por besoj se i nderuari, përfaqëson komandantin e Gardës. Nuk e di se kush do të më përgjigjet zoti Hodaj apo përfaqësuesi i Gardës.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Murrizi!

Besoj se edhe zoti Hodaj edhe zoti Dervishi kanë përgjigje për pyetjet tuaja.

Julian Hodaj – Faleminderit!

Unë do ta ndalem të diskutojmë sot për nivelin në parim.

Në lidhje me pyetjen nëse ka disa projektligje, ka pasur një grup pune, që ka punuar pranë Ministrisë së Brendshme, që ka qenë i drejtuar nga komandanti i Gardës, i cili për arsye objektive, doja t'i thosha zotit Murrizi që nuk gjendet me ne në komision sot, sepse patjetër që do të ishte. Prandaj nuk dua të krijoj një keqkuptim në lidhje me faktin, por, gjithsesi, edhe zotërinjtë Gardës kanë tagër të plotë për ta përfaqësuar këtë institucion përballë këtij komisioni.

Në këtë projektligj, që ju është paraqitur nga Këshilli i Ministrave, pas shumë diskutimeve edhe në grupin e punës, pas marrjes së mendimeve edhe nga institucionet e tjera, Këshilli i Ministrave ka ardhur me një propozim konkret. Kuptohet që disa mendime të institucioneve të tjera edhe janë reflektuar në këtë projektligj dhe nuk ka nevojë të përmend që komisioni është organi përgjegjës dhe më pas seanca që miraton versionin përfundimtar. Kështu që, edhe ato që mund të jenë dilemat qoftë tuajat, qoftë të kolegëve tuaj, sugjerimet, rekomandimet për ta përmirësuar këtë projektligj, patjetër që komisioni do t'i marrë parasysh, do t'i diskutojë dhe ne do të jemi shumë të lumtur të japim edhe mendimin tonë.

Në lidhje me pyetjen e dytë, kryesisht është marrë për model ligji polak.

Myslim Murrizi – Nuk gjetët një vend tjetër, po një vend ish- komunist të merrnit si shembull?

Juljan Hodaj – Zoti Murrizi, ju mbase e dini më mirë se unë se... *(Shkëputje)*... shtetërore nuk kanë ekzistuar në Europën Perëndimore. Kryesisht këto detyra në Europën Perëndimore i kryejnë forcat e sigurisë ose forcat e policisë, pavarësisht emrit që mund të kenë. Pra, nëse do të marrim një shembuj që nga Italia, Franca ose të tjera, kemi edhe struktura, që kanë të njëjtën organizim, funksionim dhe status si Garda e Republikës. Pra, nëse përmendim karabinierët ose xhandarmëritë, që janë struktura gjysmë ushtarake, por tashmë forca civile, që e kryejnë këtë lloj shërbimi dhe e kryejnë mbi bazën e ligjeve ekzistuese. Duke qenë se Polonia

kishte modelin më të afërt të asaj që ishte Garda e Republikës, një pjesë e mirë e dispozitave janë marrë si objekt pune dhe pastaj është arritur në atë që ju keni përpara.

Sa i përket tabelës së pagave..

Myslim Murrizi – Nuk ka Italia Gardë Kombëtare?

Juljan Hodaj – Italia nuk ka Gardë Kombëtare.

Myslim Murrizi – Po Franca nuk ka Gardë Kombëtare?

Juljan Hodaj – Shërbimin e Ruajtjes së Personaliteteve, sipas territorit në Itali ose në Francë, e kryejnë ose forcat e policisë, ose forcat e karabinierëve, ose xhandarmërisë. Kështu të gjitha këto janë forca të sigurisë publike, pra tashmë forca civile. Praktikisht edhe me këtë veçori që Garda e Republikës, ne po shkojmë aty ku kanë shkuar edhe vendet perëndimore.

Ju përmenda ligjin polak, sepse ai ishte nga i cili mund të mësonim më shumë, por nuk do të thotë që ligji polak është transpozuar në këtë që ju keni para.

Sa i takon tabelës së pagave, është e vërtetë ka pluse-minuse, por të vogla. Nëse ju e shihni ka minuse në drejtorin e përgjithshëm, ose në disa grada të niveli të lartë, por ka një rritje të mirë në nivelin bazë, që është pikërisht ajo që kemi synuar. Një nga problemet që kemi hasur në Ministrinë e Brendshme është që policët i kemi të trajtuar më mirë se punonjësit e Gardës në nivele financiare dhe jemi munduar që t'i përafrojmë. Unë besoj se është e ndershme, sepse në fund të ditës edhe Garda e Republikës kryen një funksion me dobi në funksion të sigurisë publike në Shqipëri.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Dervishaj.

Krenar Dervishi –Faleminderit!

Lidhur me pyetjen e deputetit Murrizi, unë e falënderoj!

Së pari, dua të sqaroj se komandanti i Gardës është në pamundësi për arsye shëndetësore për situatën e COVID-it...

Myslim Murrizi – Nuk kërkova hesap, sepse e di ku është komandanti i Gardës.

Krenar Dervishi – Pra, është në një situatë postkovid, është duke u përkujdesur për shëndetin. Fatmirësisht, gjendja është e stabilizuar dhe gjithsesi na ka dhënë tagrin për ta përfaqësuar.

Unë do të doja të plotësoja diçka lidhur me përvojat. Ne kemi studiuar përvoja të shumë vendeve europiane, përveç përvojës që mbartim në kaq vjet nga bashkëpunimi me strukturat homologe. Ajo që është specifike është ajo që zëvendësministri e përmendi, është ndryshe në Europën Perëndimore dhe është ndryshe në vendet që zoti Murrizi i quajti ish- komuniste, por që ne jemi në hapa të njëjtë për t'u përafroar me legjisllacionin europian. Ligji polak, të cilit ne

përgjithësisht i jemi referuar, është miratuar në vitin 2017. Natyrisht mbart edhe asistencën e ekspertëve të BE-së. Ne na u duk ligji më i përshtatshëm, sepse përafron shumë edhe me organizmin, edhe me misionin, edhe me mënyrën e kryerjes së detyrave nga Garda e Republikës.

Sa i takon problemit të pagave, për të cilin zoti Murrizi bëri pyetje, unë mund të them se për herë të parë në Gardën e Republikës ka një rritje pagash, që është e konsiderueshme, nëse marrim parasysh edhe situatën, edhe gjendjen në të cilën ndodhemi dhe është ajo që specifikisht përmendi zëvendësministri, që parimi ka qenë që të rriten pagat e nivelit të ulët dhe të zbutet diferenca me pagat e gradave të larta.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Pra, është e qartë, ne kemi një projekt, ju keni qenë të përfshirë në grupin e punës, në raport me variantin përfundimtar të projekti, që i është sjellë në Kuvend, ju keni disa kontestime, të cilat besoj se Ministria e Brendshme duhet të jetë e informuar, por tani këto i janë bërë prezent edhe Komisionit të Sigurisë dhe kjo ishte arsyeja që ju sot ishit të ftuar.

Ndërkohë, ne do t'i japim vetes mundësinë të diskutojmë secilin nga këto qëndrime, por të marrim parasysh edhe qëndrimet e kolegëve të Komisionit të Ligjeve, i cili është për dhënie mendimi. Pra, puna jonë nuk fillon e mbaron sot, do të zgjasë edhe pak, sa të zgjedhim variantin më të mirë dhe më konsensual.

Zonja Xhina.

Elena Xhina- Përshendetje!

Falënderoj, zotin Hodaj, për prezantimin e projektligjit!

Gjithashtu, falënderoj edhe relatoren, për sqarimin e hollësishëm që i bëri projektligjit!

Pyetja ime lidhet me nenin 20, ku flitet për kriteret e pranimit të punonjësve të Gardës. Aty shohim që janë shtuar disa kriteret të reja në krahasim me ligjin ekzistues. Këto kriteret të reja pranimi, zoti Hodaj, a sjellin ndryshim, a sjellin ndonjë penalizim të punonjësit aktual të Gardës? Pra, a rrezikohen punonjësit aktualë që për shkak të këtyre kriterëve të reja të pranimit të dalin pa punë? A keni bërë ju një analizë të tillë? Sepse ne shohim që punonjësi i Gardës duhet të jetë i moshës 19-30 vjeç. A keni ju punonjës të Gardës që janë mbi këtë moshë dhe rrezikojnë të mbeten pa punë për shkak të këtij kriteri të parashikuar?

Pyetja e dytë lidhet me terminologjinë e re “vërtetim i besueshmërisë”, nga cili institucion lëshohet ky vërtetim?

Këto ishin dy pyetjet e mia, ju përgëzoj për projektligjin, pasi ka një kuadër ligjor shumë të plotë dhe që e reformon tërësisht Gardën.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Po, zoti Hodaj.

Juljan Hodaj- Faleminderit!

Unë besoj se këto çështje do t'i diskutojmë me detaje kur të kalojmë te diskutimi nën për nen, meqenëse iu referuat neneve specifike. Gjithsesi, vetëm për një shpjegim paraprak, unë do të thosha që në nenin 20 janë kriteret e pranimit në garë. Kjo nuk prek punonjësit ekzistues, pra nuk janë kritere të qëndrimit në Gardë. Kjo do të thotë që këtej e tutje me hyrjen në fuqi të ligjit të gjitha pranimet e reja do të duhet të respektojnë këto kritere. Nëse e shini në raport me kriteret ekzistuese, ato janë më të forta dhe më të përforcuara, sepse Ministria e Brendshme ka që nga viti 2013 që ka një objektiv, që është specifikuar më tej edhe në mandatin qeverisës të vitit 2017, pra të krijohen institucione të forta me profesionalizëm dhe integritet.

Së dyti, vërtetimi i besueshmërisë sot është diçka që kërkohet për të punuar kudo në fushën e sigurisë publike. Sot që po flasim kërkohet edhe për rekrutimin e punonjësve të SHPSF-ve. Organi kryesor që e jep këtë vërtetim është Policia e Shtetit, sepse ka data bazat e nevojshëm dhe lidhet me institucionet e tjera që do të japin informacion për këtë qëllim. Kështu që nuk besoj se kjo do të ndryshojë, thjesht është një kriter përforcues që të garantohet integriteti i të gjithë atyre që do të pranohen rishtas në Gardën e Republikës. Kjo shkon krahas me verifikimin që do t'iu bëhet punonjësve të Gardës në vazhdim.

Ermonela Felaj– Zoti Dervishaj, a keni gjë për të shtrua?

Krenar Dervishi – Jo, nuk kam gjë.

Ermonela Felaj - A ka pyetje nga kolegët?

Zonja Dhima.

Antoneta Dhima- Faleminderit!

Falënderoj zëvendësministrin, për prezantimin dhe përfaqësuesin e Gardës!

Ky është një hap i rëndësishëm për funksionimin e Gardës.

Pyetja e parë është: me miratimin e këtij projektligji a do të merren parasysh të gjitha problematikat që janë krijuar deri tani me ligjin ekzistues?

Së dyti, ne si komision na ka ardhur një informacion me disa mendime dhe kontestime lidhur me projektligjin nga komandanti i Gardës së Republikës. A është bërë ndonjë konsultim me Ministrinë e Brendshme dhe me grupin e punës në lidhje me këto mendime dhe kontestime, që komandanti i Gardës ka për draftin?

Faleminderit!

Ermonela Felaj– Zoti Hodaj dhe pastaj zoti Dervishi.

Juljan Hodaj - Ideja është që nga e gjithë analiza paraprake që i është bërë funksionimit të deritanishëm dhe ju e përmendët edhe vetë, zonja kryetare, se janë 17 vjet

eksperiencë, është arritur në disa konkluzione, janë evidentuar dhe ne mendojmë që drafti aktual i adreson të gjitha ato problematika, të cilat janë konstatuar deri më sot. Mendojmë se institucioni kompletohet, demokratizohet, civilizohet dhe njëtrajtësohet me ato që janë institucionet e tjera në varësi të Ministrisë së Brendshme, duke i hequr karakterin e trashëguar ushtarak për shkak të së kaluarës dhe duke e kthyer në një institucion civil, në dispozicion të nevojave të sigurisë publike.

Për sa i përket mendimit të dytë, unë e përmenda edhe këtë, e thashë që grupi i punës ka pasur variante, ka diskutuar mbi disa variante. Versioni bazë që unë mendoj se komisioni do të ulet dhe do ta shqyrtojë është ai që ka ardhur nga Këshilli i Ministrave, por ne nuk jemi të mbyllur ndaj mundësisë së diskutimit edhe të mendimeve alternative që kanë ardhur në komision apo që janë ngritur si shqetësime për shkak të shqyrtimit të këtij projektligji. Disponibiliteti ynë është maksimal për të ruajtur rolin e të gjitha autoriteteve të përfshira, që parashikon ligji, brenda kufijve të tyre institucionalë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Hodaj!

Po, zoti Dervishi.

Krenar Dervishi – Lidhur me variantin e propozuar, sepse nuk janë dy variante, por një, natyrisht që ne me Ministrinë e Brendshme nuk jemi palë përballë, por jemi një palë dhe kemi një detyrë, një mision për ta bërë gardën me një ligj të ri dhe përpjekja është e përbashkët për ta bërë këtë gjë.

Ne kemi disa kontestime, që ju i keni përpara, të cilat i kemi diskutuar edhe me instancat e Ministrisë së Brendshme. Mendoj se, kur të shqyrtohen nen për nen, do të kemi mundësinë t'i shikojmë dhe t'i diskutojmë një nga një.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Dervishi!

Relatorja kërkon fjalën, e kam këtu pranë, në komision.

Artemis Dralo – Kam një pyetje për zotin Dervishi, në bazë të kërkesave dhe të sugjerimeve që keni dërguar, është një pretendim për ndryshimin e varësisë së emërimit të drejtorit që deri tani është kryer nga Kryeministri dhe kërkohet të kalojë në varësi dhe të jetë kompetencë të ministrit, në fakt, e anasjella. Do të doja një sqarim për këtë gjë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Dralo!

Besoj se pyetja ishte e qartë, pra ka një qëndrim tuajin që komandanti i gardës ose drejtuesi i Përgjithshëm i saj në termat e projektligjit të ri të ketë emërtesën nga Kryeministri, me propozim të ministrit të Brendshëm. Pse ky insistim që të jetë emërtesë nga Kryeministri, ndërkohë që Ministria e Brendshme në propozimin e saj ka qëndrimin se duhet të jetë emërtesë

e ministrit, për ta ruajtur atë që ka parashikuar ligji deri tani, apo ka arsye të tjera që justifikojnë qëndrimin tuaj?

Krenar Dervishi – Këmbëngulja jonë në këtë pikë është për shkak të rëndësisë që ka institucioni, por dhe të gradës madhore që ka drejtuesi i gardës. Mendojmë e gjykojmë që, për shkak edhe të detyrës, integritet që duhet të ketë drejtori i Përgjithshëm i Gardës emërimi të ishte kompetencë e Kryeministrit, me propozim të ministrit. Edhe e ruajmë nivelin siç e kemi, ashtu sikurse e thashë për shkak të gradës.

Ermonela Felaj – Faleminderit për përgjigjen!

A ka pyetje të tjera?

Zonja Pici kërkon fjalën.

Elena Pici – Faleminderit, zonja kryetare!

Doja të bëja vetëm një saktësim të vogël: neni 17 i projektligjit final, që ka paraqitur Këshilli i Ministrave në komision, përcakton pikërisht se drejtori i Përgjithshëm i Gardës emërohet nga Kryeministri me propozim të ministrit. Besoj se kjo e ka plotësuar të gjithë pritshmërinë e institucionit.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Po, zoti Hodaj.

Julian Hodaj – Ajo që doja të shtoja edhe për t'i dhënë përgjigje pyetjes, është se për ne nuk është i rëndësishëm autoriteti që emëron sesa detyrat që do të kryejë.

Zonja Pici e sqaroi se aktualisht edhe në versionin e propozuar nga Këshilli i Ministrave kjo gjë është reflektuar. Unë besoj se i takon komisionit që, kur të shqyrtohet nen për nen, të shihet që, në bazë të detyrave, duhet ky nivel emërtese ose jo. Nga ajo që kemi si eksperiencë te Policia e Shtetit është që drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, por jo për shkak të pamundësisë për ta emëruar me urdhër të Kryeministrit, por për shkak të detyrave që kryen. Unë besoj se edhe niveli i emërtesës shkon paralelisht me detyrën.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Hodaj!

Nga kolegët e tjerë, a ka pyetje?

Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, është gjë e mirë që po normohet kuadri ligjor për këtë institucion kaq të rëndësishëm. Duke marrë shkas edhe nga vizita që bëmë në Gardën e Republikës, është një gjë shumë pozitive. Unë mendoj se më shumë e rëndësishme është mënyra se si janë qasur

problemet që kanë vetë punonjësit e gardës sesa vjetërsia e ligjit apo kalimi nga ushtarë të gardës në profesionistë të ruajtjes. E shikoj se këtu kemi diçka që ndoshta duhet të sqarohet.

Kam një pyetje edhe për drejtuesit e ministrisë. Vërejtjet dhe sugjerimet e sjella nga komandanti i gardës, që uroj që të jetë mirë, sepse na inkurajon edhe ne të tjerëve, nga kontaktet që kemi është shumë mirë fizikisht, kanë ardhur si rezultat i moskonsultimit me institucionin e gardës apo mosdakordësisë që ka pasur Ministria e Brendshme, si propozuese?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia!

Po, zoti Hodja.

Julian Hodaj – Në dijeninë time, grupi i punës ka qenë drejtuar nga komandanti i gardës dhe në momentin që një grup pune përfundon punën dhe e dorëzon tek autoriteti propozues, është e detyrueshme të shpërndahet për të gjitha institucionet që mund të kenë interes të shprehen. Në versionin që ju keni përpara, janë reflektuar edhe mendimet e institucioneve, të cilat janë gjykuar se duhet të përfshiheshin.

Nuk besoj se ka një mosdakordësi, sepse ndoshta momenti i paraqitjes së këtyre ndryshimeve, shtesave apo mendimeve alternative është më i vonshëm sesa momenti kur është aprovuar ligji. Besoj se në shqyrtimin nen për nen do të keni mundësi të shqyrtoni çdo propozim alternativ, qoftë ato që mund të vijnë nga vetë institucioni i interesuar, qoftë të konsultoni mendimet e institucioneve të tjera që i kanë ardhur Ministrisë së Brendshme, që do t’ju vëmë në dispozicion, qoftë të keni mendimet tuaja në lidhje me mirorganizimin dhe mirëfunksionimin e këtij institucioni.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

A kemi ndërhyrje të tjera nga kolegë apo të ftuarit?

Nuk ka. Më vjen mirë që zoti Hodaj është i hapur, në emër të Ministrisë së Brendshme, për t’i diskutuar edhe një herë disa pika, të cilat duken që nuk kanë një pranim të plotë nga ana e punonjësve të Gardës së Republikës.

Gjatë diskutimit nen për nen ne do të t’i shqyrtojmë një për një këto momente, por unë do t’ju ftoja, meqenëse nuk jeni përballë njëri-tjetri, por jeni i njëjti institucion, të mund të uleni dhe t’i shikoni paraprakisht cilat janë ato momente, për të cilat ju mund të bini dakord ose nuk jeni kuptuar drejt, sepse, edhe nga materiali shkresor që na është vënë në dispozicion, shihet qartë që disa dispozita më shumë kanë moskuptim, sepse, në fakt, qëndrimi është i njëjtë, pra nuk ka ndryshime thelbësore. Do t’ju ftoja ta bëni këtë gjë paraprakisht dhe, njëkohësisht, relatoren e keni të gatshme t’ju vijë në ndihmë në çdo kohë.

Nga ana tjetër, duhet të jeni të hapur, sepse ka një interes ky projekt për të gjithë punonjësit që janë në gardë. Ata janë të interesuarit e parë për të kuptuar se cili do të jetë pozicionimi i ardhshëm i tyre, cili do të jetë trajtimi i tyre i ardhshëm financiar. Ka qenë kjo një kërkesë e vjetër e Gardës së Republikës që ata të trajtohen njëlloj si Policia e Shtetit në kuptimin e përfitimeve financiare, sepse edhe shërbimet që ofrojnë janë tejet të rëndësishme, në jo pak raste për shkak të detyrës këta punonjës kanë rrezikuar edhe jetën, edhe shëndetin e tyre. Të gjitha këto duhet t’i njohim dhe t’i trajtojmë drejt përmes ligjit të ri që propozohet.

Kolegë, zoti Murrizi, zoti Shehu, duhet të bëjmë miratimin në parim dhe na duhet kuorumi sërish. Zoti Murrizi, zoti Shehu, ju lutem, me kamera! Zoti Vorpsi?

Në mos gaboj, në datën 8 mars projekti është parashikuar të kalojë në seancën plenare, prandaj duhet ta shfrytëzoni kohën maksimalisht për ato momente, për të cilat nuk keni dakordësi të plotë.

Kolegë, kush është dakord me miratimin në parim të projektligjit “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projekt.

Faleminderit, kolegë, për prezencën tuja gjatë ditës së sotme!

Faleminderit përfaqësuesve të ministrisë për prezantimin që i bënë projektit të ri të ligjit “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”. Takohemi në diskutimin nen për nen.

Punë të mbarë të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA